



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:197366
Datë: 20.06.2024
Numri i dokumentit: 05841206

KP.nr. 29/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen juridike të Paditësit “Ndërmarrja Publike Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës – INFRAKOS Sh.A., me seli në Fushë Kosovë, kundër të paditurit “Viva Fresh” Sh.p.k me seli në fshatin Suhudoll, Komuna Lipjan, me objekt kontesti lirimimi i pronës dhe kompensimi i dëmit, duke vendosur sipas parashtrësës së paditësit për tërheqje të padisë, jashtë seance me datën 20.06.2024 merr këtë :

A K T V E N D I M

Konstatohet e tërhequr padia e paditësit “Ndërmarrja Publike Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës – INFRAKOS Sh.A., e ushtruar më datën 27.08.2021, kundër të “Viva Fresh” Sh.p.k për lirimimin e pronës dhe kompensimin e dëmit.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, në Gjykatën Themelore Gjakovë – Dega Rahovec, më datën 27.08.2021, ka ushtruar padi ndaj të paditurit “Viva Fresh” Sh.p.k me të cilën ka kërkuar lirimine pronës në sipërfaqe prej 230m² dhe kompensimin dëmit.

Gjykata Themelore Gjakovë – Dega Rahovec me Aktvendimin C.nr.902/2021 të datës 13.11.2023 është shpallur jo kompetente lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike dhe pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi lënda së bashku me shkresat e saj të dërgohet në kompetencë lëndore në Gjykatën Komerciale.

Paditësi përmes parashtrësës së datës 13.06.2024, i është drejtuar kësaj gjykate, dhe ka kërkuar që të konsiderohet e tërhequr padia e paditësit, pasi që me të paditurit kanë arritur marrëveshje

ndërmjetësimi me anë të së cilës e paditura ka kompensuar dëmin material siç ka kërkuar dhe si rrjedhojë e tërheqë padinë.

Gjykata duke vepruar sipas parashtrësës për tërheqje të padisë, konstatoj se paditësi po e tërheq padinë, andaj në kuptim të nenit 261 lidhur me nenin 387.1 pika c) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti i Përgjithshëm

KP.nr.29/24, datë 20.06.2024

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.